



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË  
Nr. 2789  
Datë, më 31.03.2022

V E N D I M

Nr. 190, datë 30.3.2022

P Ë R

**MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR SHPËRNDARJEN E KOSTOVE  
TË LIDHURA ME KOORDINIMIN E PUNIMEVE CIVILE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 15, të ligjit nr.120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullave për shpërndarjen e kostove të lidhura me koordinimin e punimeve civile, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen autoritetet përgjegjëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, sipas përcaktimeve në nenin 7, të ligjit nr.120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të



komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ARBEN AHMETAJ**

**MINISTRI I INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË**

**BELINDA BALLUKU**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSMINISTRI**

**ILIR BEJTJA**





**RREGULLA  
PËR SHPËRNDARJEN E KOSTOVE TË LIDHURA ME  
KOORDINIMIN E PUNIMEVE CIVILE**

**Neni 1  
Objekti**

Ky dokument ka si objekt përcaktimin e rregullave për shpërndarjen e kostove të lidhura me koordinimin e punimeve civile.

**Neni 2  
Qëllimi**

Qëllimi i këtyre rregullave është lehtësimi i kostove për ndërtimin e rrjeteve të shpejtësisë së lartë të komunikimeve elektronike përmes koordinimit të punëve civile.

**Neni 3  
Parime të koordinimit të punimeve civile**

1. Koordinimi i punimeve civile në ndërtimin e rrjeteve të shpejtësisë së lartë të komunikimeve elektronike bazohet në parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe orientimit në kosto.
2. Koordinimi i punimeve civile për ndërtimin e rrjeteve të shpejtësisë së lartë të komunikimeve elektronike bëhet mbi bazën e kërkesës së palës së interesuar dhe pranohet në rastet e parashikuara në ligj.

**Neni 4  
Përkufizime**

Termat e përdorur në këtë dokument kanë të njëjtin kuptim me përkufizimet e dhëna në ligjin nr.120/2016, "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit".

**Neni 5  
Shpërndarja e kostove të lidhura me koordinimin e punimeve civile**

1. Në rastin e pjesëmarrjes së më shumë se një operatori rrjeti në punimet civile për ndërtimin e rrjetit/eve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë, kostot për punimet civile ndahen në mënyrë përpjesëtimore midis pjesëmarrësve.



2. Në rastin kur punimet civile për ndërtimin e rrjetit të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë kanë filluar nga një operator i rrjetit të infrastrukturave, me paraqitjen e kërkesës dhe pranimin e saj sipas parashikimeve në ligj për koordinimin e punimeve civile, të gjitha kostot/shpenzimet respektive për kryerjen e punimeve civile për shtrimin e rrjetit/eve respektive ndahen midis operatorëve pjesëmarrës sipas formulës:

$$K_i = \text{Kosto Totale} * P_i / n$$

“K<sub>i</sub>” është kostoja që do të paguajë secili operator.

$$\text{Kostoja Totale} = k_1 + k_2 + \dots + k_j$$

Me “k<sub>j</sub>” janë shënuar elementet e kostove të punimeve civile (gërmim dheu, zhvendosje të dheut, kthim në gjendjen e mëparshme, kosto për elementet e mirëmbajtjes/puseta etj).

Me “n” është shënuar numri total i operatorëve pjesëmarrës në koordinimin e punimeve civile.

P<sub>i</sub> – Peshë specifike për secilin pjesëmarrës

3. Peshë specifike përcaktohet mbi bazën e përqindjes në volum të punimeve të secilit sipas natyrës, llojit dhe sasisë së elementeve që kërkon ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrjetit përkatës të infrastrukturës.

## **Neni 6**

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Në rast të mosmarrëveshjeve për koordinimin e punimeve civile, pala e interesuar i drejtohet autoritetit përgjegjës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas përcaktimeve në nenin 7, të ligjit nr.120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”.





NR PROT. 1542/1  
DATË 30.3.2022

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE  
ENERGJISË  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjell AGAÇI**



